**VENDIM**
**Nr. 297, datë 30.12.2024**

# MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQATËS SHQIPTARE TË FURNIZUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE (AAES) PËR DISA NDRYSHIME DHE KUFIZIME NË ZBATIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 186, DATË 6.6.2023

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 33, pika 1, germa "a", 105 dhe 144, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të neneve 15 dhe 16, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Konsumatore me nr. 2447/6 prot., datë 26.12.2024, "Mbi shqyrtimin e kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 6.6.2023",

konstatoi se:

- Shoqata AAES, me anë të shkresës me nr. 2111 prot., datë 21.11.2024, protokolluar në ERE me nr. 2447 prot., datë 25.11.2024, paraqiti kërkesën për zgjatjen e afatit të derogimit të pjesshëm të dispozitave të "Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.2.2022, të ndryshuar me vendimin nr. 186, datë 6.6.2023 dhe së fundmi me vendimin nr. 44, datë 29.3.2024 deri më datë 31.12.2025.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 186, datë 6.6.2023, vendosi të përjashtojë të gjithë furnizuesit që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit në treg të lirë nga detyrimi për implementimin e masave të parashikuara në nenin 1.2, germat: "a", "b", "d", "e", "f", "g" dhe "j", si dhe në nenet 2.1, 2.2 , 4.1 dhe 4.2, të "Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.2.2022 deri më datë 31.12.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) dhe vlerësimit të kushteve të operimit të furnizuesve në tregun e lirë, si dhe nivelit të hapjes dhe liberalizimit të tij, ERE, me vendimin nr. 44, datë 29.3.2024, vendosi, ndër të tjera, që: Furnizuesit që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit në treg të liberalizuar, të cilët furnizojnë njëkohësisht më pak se 100 konsumatorë, përjashtohen deri në datën 31.12.2024 nga detyrimi për implementimin e masave të parashikuara në nenin 1.2, germat: "a", "b", "d", "e", "f", "g" dhe "j", në nenet 2.1 dhe 2.2, si dhe në nenet 4.1 dhe 4.2.

- Sipas të dhënave të raportuara nga Operatorët e Rrjetit të Energjisë Elektrike, rezulton se, për periudhën 1 janar 2024 deri në tetor 2024, numri i klientëve përfitues nga shërbimi i furnizimit në treg të lirë është 2.203 klientë, nga të cilët 15 klientë janë të lidhur në Sistemin e Transmetimit dhe 2.188 klientë janë të lidhur në Sistemin e Shpërndarjes (në rrjetin 35/20 kV), ku 93 klientë janë të lidhur në rrjetin 35 kw dhe 2095 në rrjetin 20 kV.

- Sipas të dhënave të përpunuara nga ERE mbi raportimet e të licencuarve për zbatimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit, rezulton se gjatë 3-mujorit të dytë të vitit 2024, nga 30 furnizues të licencuar, vetëm 8 prej tyre kanë ushtruar aktivitet në tregun e liberalizuar.

- Gjatë vitit 2024 është vërejtur një numër i vogël ankesash nga klientët e furnizuar në tregun e lirë. Më datë 19.12.2024, ERE organizoi një seancë dëgjimore, të thirrur me urdhrin e Kryetarit të ERE-së, datë 11.12.2024. Në këtë seancë morën pjesë përfaqësues të Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) dhe shoqërive "GEN-I" sh.p.k., "FTL" sh.a., "Dragobia Energy Trade" sh.p.k., "KESH" sh.a., "Ener Trade" sh.p.k., dhe "NRG Energy" sh.p.k.

Diskutimet u përqendruan në shtyrjen e afatit për zbatimin e dispozitave ligjore të "Rregullores mbi masat për të licencuarit në aktivitetin e furnizimit, me fokus në përmbushjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit" nga ERE. Gjatë seancës, palët u dakordësuan që furnizuesit e energjisë elektrike që furnizojnë më pak se 100 konsumatorë njëkohësisht të përjashtohen nga detyrimi për zbatimin e masave të përcaktuara në nenin 1.2, germat: "a", "b", "d", "e", "f", "g" dhe "j", si dhe në nenet 2.1, 2.2, 4.1 dhe 4.2, të "Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit" nga ERE. Në rast të kundërt, këto dispozita do të jenë të zbatueshme. Furnizuesit janë të detyruar të njoftojnë ERE-n sa herë që arrijnë kriterin e furnizimit të 100 konsumatorëve njëkohësisht dhe të dokumentojnë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në dispozitat e deroguara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e pjesshëm të kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 6.6.2023.

2. Pika 2 e dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 6.6.2023, ndryshon dhe bëhet:

"- Çdo furnizues që operon në tregun e liberalizuar dhe furnizon njëkohësisht të paktën 100 konsumatorë është i detyruar të zbatojë masat e përcaktuara në nenin 1.2, germat: "a", "b", "d", "e", "f", "g" dhe "j", si dhe në nenet 2.1, 2.2, 4.1 dhe 4.2, të "Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit".".

3. Të gjithë furnizuesit janë të detyruar të njoftojnë ERE-n sa herë që arrijnë kriterin e furnizimit të 100 konsumatorëve njëkohësisht dhe të dokumentojnë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në dispozitat e deroguara, brenda 10 ditëve nga plotësimi i këtyre kushteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**